



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0277**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga, Vedat Poterqoi Kryetar, Agon Ramadani - Anëtar dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik “Nika PrO- Ing” sh.p.k., me seli në Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së re” me nr. të prokurimit: 616-22-14609-5-1-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e autoritetit kontraktues, me datën 10/07/2023, mori

## **Vendim**

1.Hedhet poshtë si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik OE “Nika PrO- Ing sh.p.k.”, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 15/05/2023, numër protokolli 2023/0277, për aktivitetin e prokurimit “Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së re” me nr. të prokurimit: 616-22-14609-5-1-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, pasi që OE ankues konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-së.

2. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datë 05.01.2023,ka publikuar Njoftimin për Kontratë, ndërsa me datën 20.04.2023, AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull:“Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së re” me nr. të prokurimit: 616-22-14609-5-1-1, për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “NBT-Ing”sh.p.k.me seli në Suharek. Kërkesa për ri

shqyrtim e OE ankues “Nika Pro- Ing” sh.p.k.,me seli në Ferizaj, është bërë me datë 25.04.2023, si dhe vendimi për refuzim të kërkesës për ri shqyrtim nga AK me datë 04.05.2023.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE “Nika Pro- Ing” sh.p.k.,me datën 15.05.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 277/23.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës:700.000 €

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 28 shkurt 2023 ka rekomanduar që:

- Refuzohet si e pa bazuar ankesa e “Nika Pro- Ing” sh.p.k, me seli në Ferizaj
- Të mbetet në fuqi vendimin e AK-së i datës 20.04.2023(vendim për dhënie të Kontratës)

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE “Nika Pro- Ing” sh.p.k, me seli në Ferizaj

Pas pranimit të ankesës, eksperti shqyrtues ka ndërmarrë disa veprime me qëllim të vlerësimit sa më profesional të ankesës me nr. 277/23. Sa për sqarim, ankesa nuk është iniciuar nga lideri i konzorciumit sipas marrëveshjes së bashkëpunimit për themelimin e konzorciumit. Lidhur me sqarimin sa më të thellë të kësaj shtate, me datë 13.06.2023, kam kërkuar me shkrim nga anëtari i konzorciumit ( pretenduesi ankimor ) të na dërgoj autorizimin nga lideri i konzorciumit me rastin e inicimit të ankesës dhe deri me datën 16.06.2023 nuk kam pranuar përgjigje.

Andaj, duke analizuar bazën ankimore të pretenduesit, eksperti shqyrtues, vlerëson se ankesa e OE “Nika Pro-Ing” sh.p.k është e palejuar sepse nuk ka qenë i autorizuar nga bartësi i projektit për përfaqësim në ankesë, për faktin se në marrëveshjen për krijimin e konzorciumit janë evidentuar nene specifike të cilat përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësit e anëtarëve të konzorciumit si:

1. Nëse i referohemi marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të OE „Engineering RK SHPK dhe NIKA Pro-ING SHPK, në nenin 2, sqarohet saktë se lideri i konzorciumit, OE Engineering RK sh.p.k., është bartës i projektit dhe i autorizuar që të firmos të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën.

2. Pastaj në nenin 10 të marrëveshjes saktësohet se: citoj,, Kjo marrëveshje nuk i jep asnjërës palë të drejtën që në emër të palëve të tjera të pajtuara të ndërmarrë kurrfarë detyrimesh të cilat mund ta detyrojnë pa pajtim të veçantë me shkrim, përfaqësimin dhe prezantimin e palës tjetër, e që duhet të sigurohet vetëm me autorizim të veçantë.

Nga kjo, vlerësoj se palët me vullnet të plotë kanë autorizuar liderin si përfaqësues me të gjitha të drejtat lidhur me këtë tender, si: përgatitja e DT, dorëzimi i tenderit, nënshkrimi i të gjitha dokumenteve në emër të grupit, konzorciumit. Si rezultat i vlerësimeve të cekura më lartë, eksperti shqyrtues vlerëson se anëtari i konzorciumit nuk i plotëson kushtet administrative të përfaqësimit dhe rrjedhimisht nuk ka pas ë të drejtë të krijoj apo përfaqësoj grupin në parashtrimin e ankesës në OSHP, dhe si e tillë kjo ankesë është e pa lejuar.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

### *-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues-*

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli për faktin se i njejtë ka paraqitur fakte dhe rekomandime bindëse të bazuara në gjendjen faktike si dhe dispozitat ligjore rregulluese relevante me çështjen në fjalë andaj si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE “Nika Pro-Ing” sh.p.k, hedhet si e palejuar.

Me datën 15.05.2023, Operatori Ekonomik ankues “Nika Pro-Ing” sh.p.k,ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 0277/2023, për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Aktivitet ky në të cilin ka ofertuar Grup i Operatorëve Ekonomik ,Engineering RK SHPK dhe NIKA Pro-ING SHPK

OE “Engineering RK SHPK”, nga ana e ekspertit shqyrtues dhe panelit është evidentuar se është lider i grupit të operatorëve ekonomik, që i bie se ankesa nuk është inicuar nga lideri i konzorciumit sipas marrëveshjes së bashkëpunimit për themelimin e konzorciumit. PSH e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues për faktin se në marrëveshjen për krijimin e konzorciumit janë evidentuar nene specifike të cilat përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësit e anëtarëve të konzorciumit se OE Engineering RK sh.p.k., është bartës i projektit dhe i autorizuar që të firmos të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën dhe se kjo marrëveshje nuk i jep asnjërës palë të drejtën që në emër të palëve të tjera të pajtuara të ndërmarrë kurrfarë detyrimesh të cilat mund ta detyrojnë pa pajtim të veçantë me shkrim, përfaqësimin dhe prezantimin e palës tjetër, e që duhet të sigurohet vetëm me autorizim të veçantë.

Andaj, duke analizuar bazën ankimore të pretenduesit, eksperti shqyrtues, vlerëson se ankesa e OE “Nika Pro-Ing” sh.p.k është e palejuar sepse nuk ka qenë i autorizuar nga bartësi i projektit për përfaqësim në ankesë, për faktin se në marrëveshjen për krijimin e konzorciumit janë evidentuar nenet specifike të cilat përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësit e anëtarëve të konzorciumit. Nga kjo, PSH vlerëson se palët me vullnet të plotë kanë autorizuar liderin si përfaqësues me të gjitha të drejtat lidhur me këtë tender, si: përgatitja e DT, dorëzimi i tenderit, nënshkrimi i të gjitha dokumenteve në emër të grupit, konzorciumit .Si rezultat i vlerësimeve të cekura më lartë, PSH vlerëson se anëtari i konzorciumit nuk i plotëson kushtet administrative të

përfaqësimit dhe rrjedhimisht nuk ka të drejtë të krijoj apo përfaqësoj grupin në parashtrimin e ankesës në OSHP, dhe si e tillë kjo ankesë është e pa lejuar. Ndërsa, lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë, mbetet në përgjegjësi të plotë të AK se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore për prokurim publik.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...”

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: